

KËRKESË
Nr. 872/7, datë 21.5.2012

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve Publike dhe Transportit shpall kërkesën për shpronësim për interes publik, të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Bulevardi “Bajram Curri”-rruga “Ali Demi”, faza II” Tiranë.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Bashkia e Tiranës. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike dhe Transportit).

Pronarët për të cilët në kolonën shënime në tabelën e publikuar, është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZRPP” do të kompensohen për efekt shpronësimi pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë të rifreskuar pranë Bashkisë së Tiranës (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik”).

Pronarët e pasurive, për të cilët është bërë shënimi “Bllokim hipotekor në favor të BTA”, do të likuidohen për efekt shpronësimi pasi të jetë hequr barra hipotekore.

Për pasuritë për të cilat është bërë shënimi “rikonfirmim” me pronar të pavërtetuar, personat të cilët pretendojnë pronësinë duhet të aplikojnë për regjistrimin e këtyre pasurive, në të kundërt nuk do të kompensohen për efekt shpronësimi.

Për pasurinë për të cilën është bërë shënimi “Verifikim”, sqarojmë se do të verifikohen të dhënat pranë ZVRPP-së, Tiranë.

Për pasurinë me shënimin “Rikonfirmim”, sqarojmë se do të kërkojmë edhe një herë konfirmimin e titullit të pronësisë pranë ZVRPP-së Tiranë.

Për pasurinë në “Proces regjistrimi”, pronari përkatës do të likuidohet për efekt shpronësimi pas përfundimit të këtij procesi, si dhe në bazë të dokumentacionit që do të dorëzojë pranë Bashkisë së Tiranës.

Vlera totale e shpronësimit është 123 619 047.2 (njëqind e njëzet e tre milionë e gjashtëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e dyzet e shtatë pikë dy) lekë.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
Sokol Olldashi